



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.360/2024

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin individual Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “Frigo Avi” shpk, me NUI: 810822727, me seli ne rr.”R. Krasniqi” nr.177 ne Prishtinë, kundër debitorit “AB Concept” shpk, me NUI: 811894915, me seli ne rr.” Gërvalla” BL.7 H-4 nr.11 Aktash III ne Prishtinë, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës - Dhomat e Shkalles se parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.513/23, të datës 05.09.2023, me datën 15.07.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e debitorit “AB Concept” shpk me NUI: 811894915, me seli ne rr.” Gërvalla” BL.7 H-4 nr.11 Aktash III ne Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës-Dhomat e Shkallës se Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.513/23, të datës 05.09.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkalles se parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.513/23, të datës 05.09.2023, e ka refuzuar ne tërësi si te pabazuar prapësimin e debitorit “AB Concept” shpk, me NUI 811894915, me seli ne rr.” Gërvalla” BL.7 H-4 nr.11 Aktash III ne Prishtinë, ndërsa Urdhrin përmbarimor P.nr.36/23 dt.01.02.2023, te lejuar nga Përmbaruesi Privat Destan Bujupaj, me seli ne Prishtinë e ka Lënë ne fuqi.

Kundër atij aktvendimi, ne afat ligjor, ka paraqitur ankesë debitori, përmes avokat Agron Krasniqi, për shkak te shkeljeve thelbësore te dispozitave te procedurës përmbarimore dhe konstatimit te gabuar apo jo te plotë te gjendjes faktike, me propozim qe gjykata e shkalles se dytë ta aprovoj këtë ankesë, aktvendimin e atakuar ta anuloj, ndërsa urdhrin përmbarimor ta shfuqizoj si dhe te refuzohet prapësimi për përmbarim i kreditorit.

Dhoma e Shkalles e Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa e debitorit është e pabazuar

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori “Frigo Avi” shpk, me NUI 810822727, me seli ne rr.”Krasniqi” nr.177 ne Prishtinë, me datën 31.01.2023, ka paraqitur propozim për përmbarrim ndaj debitorit “AB Concept” L.L.C, me NUI 811894915, me seli ne rr.” Gërvalla” BL.7 H-4 nr.11 Aktash III ne Prishtinë, në bazë të dokumentit të besueshëm-Faturave nr.310/22 dt.01.09.2022, 317/22 dt.05.09.2022, 318/22 dt.05.09.2022.

Përmbarruesi Privat Destan Bujupaj, duke vepruar sipas propozimit për përmbarrim të kreditorit, me urdhrin përmbarrimor P.nr.36/23 dt.01.02.2023, ka lejuar përmbarrimin me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër te borxhit nga faturat, t’i paguaj shumën prej 10,867.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% si edhe shpenzimet e krijuara.

Kundër këtij urdhri me datën 22.03.2023, debitori ka ushtruar prapësim, duke e kundërshtuar urdhrin përmbarrimor me pretendimin se nga kartela financiare shifen transaksionet e te dy palëve dhe se me datën 31.12.2021 palet kanë bere barazimin e obligimeve-prerja e fundit, nga figuron se tani debitori i ka pasur obligim kreditorit vetëm shumen prej 24,794.10 euro ndërsa gjatë vitit 2021 deri me datën 05.09.2022 debitori ka paguar shumen prej 60,000.00 euro përderisa faturat janë pranuar ne shumen prej 26,059.00 euro, pretendon se debitori është ne parapagim ose ka bere pagesa më shumë, ne vlerën prej 9,146.90 euro, çka nënkupton se faturat e kreditorit janë paguar, propozon qe gjykata ta aprovoj prapësimin e debitorit, ta anuloj urdhrin përmbarrimor dhe ta detyroj kreditorin ne pagesën e shpenzimeve.

Përgjigje ne prapësimin e debitorit ka ushtruar kreditori me datën 24.03.2023, me pretendimin se nuk qëndrojnë arsyet e dhëna ne prapësim sepse debitori nuk ka parashtruar asnjë dëshmi me të cilën dëshmon se nuk ka borxh ndaj kreditorit, faturat e lëshuara nga kreditori janë ne origjinal, te nënshkruara dhe pranuar nga debitori, propozon qe gjykata ta refuzoj prapësimin e debitorit dhe i njëjti te paguaj shpenzime e procedurës.

Gjykata e shkallës së parë, pas analizimit te prapësimin dhe përgjigjes ne prapësim, ka nxjerr aktvendimin KPPP.nr.1513/23 te datës 05.09.2023 me të cilin ka refuzuar si te pabazuar prapësimin e debitorit dhe ka lënë ne fuqi urdhrin përmbarrimor, duke vendosur si ne dispozitiv te aktvendimit. Ne aktvendimin e saj gjykata ka vlerësuar faturat mbi bazën e te cilave është iniciuar procedura e përmbarrimit si dokumente te besueshme dhe ne pajtim me nenin 29 par.3 dhe nenin 37 te LPP. Gjykata ka vlerësuar rregullsinë dhe përshtatshmërinë e dokumentit te besueshëm ndërsa pretendimet e debitorit ne prapësim i ka vlerësuar si te pabazuara dhe paargumentuara, andaj edhe vendosi si ne dispozitivi te këtij aktvendimi.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarrimore me rastin e vendosjes, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikim në shkresat e lëndës qartë konstatohet se faturat nr.310/22 dt.01.09.2022, 317/22 dt.05.09.2022, 318/22 dt.05.09.2022 mbi bazën e te cilave është lejuar përmbarrimi i plotësojnë kushtet për te qenë dokumente te besueshme konform nenit 29 par.3 te LPP i cili parasheh qe se “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarrim po qe se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes se detyrimit monetar*”, si edhe Udhëzimi Administrativ Nr.15/2010 për zbatimin e Ligjit nr. 03/1-222 mbi Administratën

Tatimore dhe Procedurat, i cili ne nenin 20 par.1 nenpar.1.17 parasheh qe “Në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është dispozicion për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruajë faturën tatimore”, e që në rastin konkret faturat janë të nënshkruara nga debitori dhe janë pranuar në mënyrë të rregullt nga i njëjti, andaj si të tilla plotësojnë kushtet ligjore për tu ekzekutuar.

Në rastin konkret Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe Gjykata e shkallës së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të LPK dhe e as në konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Përndryshe, në procedurën përmbartimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbartimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbartues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbartimin.

Kjo gjykatë ka analizuar pretendimet e debitorit se faturat e kreditorit janë të paguara dhe se debitori është në parapagim duke iu referuar kështu edhe kartelës së subjektit dhe disa pagesave të cilat i ka ofruar si prova, por vlerëson se nga fletëpagesat që gjenden në lëndë nuk mund të konstatohet se këto pagesa kanë të bëjnë me faturat konkrete mbi bazën e të cilave është lejuar përmbartimi, andaj këto pretendime edhe kjo gjykatë i refuzoi si të pabazuara dhe të paargumentuara ndërsa aktvendimin e atakuar e vërtetoi.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së Dytë

K.DH.SH.II nr.360/24, me datë 15.07.2024

Gjyqtari,  
Krenar Berisha